



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Nr. _____ prot

Durrës, më _____.____.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM TË MARRËVESHJES KUADËR**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

1. OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“BLERJE KARBURANT PËR BASHKINË Durrës DHE INSTITUCIONET NË
VARËSI TË SAJ ”**

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve)

REF –78494-03-09-2026

Lot I Diesel 10 ppm ULSD:

REF- 78502-03-09-2026

Lot II Benzine Premium Unl 10 ppm:

REF- 78506-03-09-2026

TIPI I KONTRATËS- MALL

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
09134220-5; 09132100-4**

2. BAZA LIGJORE

Në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 06, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;

Në zbatim të shkresës nr. 890 prot., datë 20.01.2026, Bashkia Durrës ka ngarkuar Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale, në cilësinë e Organit Qendror Blerës (OQB), për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Karburant për Bashkinë Durrës dhe institucionet në varësi të saj”, për periudhën 2026–2027 Me urdhër nr. 49, datë 04.02.2025, është ngritur Grupi i Punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit të Marrëveshjes Kuadër. Për përcaktimin e fondit limit.

3. ORGANIZIMI I PUNËS SË GRUPIT

Grupi i Punës harton këtë procesverbal për argumentimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të marrëveshjes kuadër. Grupi i Punës programoi dhe realizoi:

- a) Grumbullimin e informacionit për përcaktimin e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi:
 - Naftë (Gazoil) 10 ppm ULSD;
 - Benzinë (Premium Unl 10 ppm);
- b) Grumbullimin dhe analizimin e informacionit mbi çmimet orientuese të tregut, për qëllim të përlogaritjes së vlerës limit të marrëveshjes kuadër.

4. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi, Grupi i Punës është mbështetur në standardet europiane të adoptuara si standarde shqiptare (S SH), si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi për cilësinë e karburanteve.

Specifikimet teknike janë hartuar si më poshtë:

- Naftë Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 590:2022 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, që përcakton karakteristikat fiziko-kimike dhe cilësore të karburantit dizel për përdorim në automjete;
- Benzinë (Premium Unl 10 ppm), Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, që përcakton kërkesat teknike dhe cilësore për benzinën pa plumb për automjete.

Produktet e furnizuara duhet të jenë në përputhje të plotë me standardet e sipërpërmendura, të shoqëruara me dokumentacion përkatës që vërteton cilësinë dhe konformitetin me standardet ligjore në fuqi.

5. METODOLOGJIA E PËRLLOGARITJES

A. Përlogaritja e nevojave sasiore

Për përcaktimin e vlerës limit të Marrëveshjes Kuadër për periudhën 2025 deri më 30.03.2026, autoriteti kontraktor është mbështetur në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe Udhëzimin nr. 06, datë 16.01.2018 për përdorimin e marrëveshjes kuadër.

Vlera limit është përlogaritur për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, duke përfshirë të gjitha kontratat specifike që parashikohen të lidhen gjatë kësaj periudhe, në përputhje me nenin 62 të VKM nr. 285/2021.

B. Fondi i parashikuar nga institucionet përfituese

Sasitë e karburantit (naftë dhe benzinë) janë përcaktuar në bazë të:

- kërkesave zyrtare të institucioneve përfituese;
- konsumit historik të viteve të mëparshme;
- planifikimit buxhetor të miratuar;
- analizës së funksioneve dhe detyrave operacionale të secilit institucion.

Përlogaritja është kryer në mënyrë gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e nevojave të paplanifikuara gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes kuadër.

Nr	Institucioni	Naftë me TVSH (lekë)	Benzinë me TVSH (lekë)	TOTAL me TVSH (lekë)
1	Ndërmarrja e Shërb. Komunale	79,470,683.3	996,950	80,467,633.3
2	Bashkia Durrës	5,832,600	—	5,832,600
3	Qendra Ditore e të Moshuarve	493.333	—	493.333
4	Klubi Shumësporteve “Teuta”	1,000,000	—	1,000,000
5	Ndërmarrja “Rruga”	40,000,000	—	40,000,000
6	Agjencia e Parqeve Urbane	5,000,000	1,500,000	6,500,000
7	Qendra Kulturore “A. Moisiu”	50,000	—	50,000
8	Ndërmarrja Komunale Plazh	55,960,000	300.000	56,260,000
9	Klubi Futbollit “Teuta”	540.000	102,200	642,200
10	MZSH	2,400,000	100.000	2,500,000

Në kontratën e mëparshme të vitit 2025, norma e fitimit ka qenë 17.8 (shtatëmbëdhjetë presje tetë) lekë/litër pa TVSH. Kjo vlerë është marrë në konsideratë si referencë krahasuese në analizën e kryer nga Grupi i Punës.

Në zbatim të nenit 45 VKM 285/2021, pika 2.1, norma e fitimit duhet të jetë e shprehur në vlerë absolute dhe e pandryshueshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

C. Përcaktimi i sasive të pritshme të karburantit

Nr	Emërtimi i Institucionit	Njësia	Naftë (10 ppm ULSD)	Benzinë (Premium Unl 10 ppm)
1	Ndërmarrja e Shërb. Komunale	Litra	474,452	6,345
2	Bashkia Durrës	Litra	34,821	
3	Qendra Ditore e të Moshuarve	Litra	2,945	
4	Klubi Shumësporteve “Teuta”	Litra	5,970	
5	Ndërmarrja “Rruga”	Litra	238,806	
6	Agjencia e Parqeve Urbane	Litra	29,851	9,547

7	Qendra Kulturore “A. Moisiu”	Litra	299	
8	Ndërmarrja Komunale Plazh	Litra	334,090	1,909
9	Klubi Futbollit “Teuta”	Litra	3,224	650
10	MZSH	Litra	14,328	636
	TOTAL	Litra	1,138,786	19,087

Nr.	Emërtimi i Mallit	Sasia e pritshme	Vlera me TVSH	Vlera pa TVSH
1	Naftë 10 ppm ULSD	1,254,480 litra	210,125,400	175,104,500
2	Benzinë Premium UL 10 ppm	20,563 litra	3,231,650	2,693,042
	Shuma		213,357,050	177,797,542

D. Përlogaritja e çmimit referencë për njësi

Në përcaktimin e çmimit referencë për njësi, Grupi i Punës ka kryer analizë të integruar të tregut, duke u mbështetur në studimin e drejtpërdrejtë të tregut vendas, në të dhënat zyrtare të publikuara nga institucionet kompetente dhe në çmimet e bursës ndërkombëtare “PLATTS”.

Në këtë kuadër janë marrë në konsideratë:

- çmimet e publikuara në Buletin e APP **Buletini nr.16 datë 23 shkurt 2026**, bazuar në informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
- çmimet referuese të bursës “**PLATTS**”, date **19 shkurt 2026** të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë date 19 shkurt 2026;
- premio tregtare mbi çmimin referues;
- elementët fiskalë të detyrueshëm (akciza, taksa e qarkullimit, taksa e karbonit, taksa e markimit dhe TVSH);
- dendësia mesatare e karburantit për konvertimin teknik nga ton në litër.

Në përputhje me nenin 45, pika 2.1, është përcaktuar norma (marzhi) fitimit në vlerë absolute 17.8 lekë/litër pa TVSH, bazuar në referencën e kontratës së mëparshme nga fatura e fundit për vitin 2025. Kjo normë është e pandryshueshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës dhe është përfshirë në strukturën e çmimit referencë për njësi.

Të gjithë elementët janë analizuar në mënyrë të integruar, me qëllim përcaktimin e një çmimi referencë të arsyetuar, të dokumentuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

E. Formula e përlogaritjes së vlerës limit

Sasisë totale të parashikuar (në litra) × Çmimit referencë për njësi (lekë/litër pa TVSH).

Çmimi referencë për njësi është përcaktuar në përputhje me nenin 45, pika 2.1, duke përfshirë çmimin e bursës, elementët fiskalë dhe normën e fitimit në vlerë absolute.

Vlera e përlogaritur përbën vlerën maksimale të pritshme të kontratës gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër dhe përfshin të gjitha furnizimet e planifikuara për mallrat objekt prokurimi.

F. Përcaktimi i vlerës përfundimtare të Marrëveshjes Kuadër

Në përfundim të analizës së të dhënave të grumbulluara dhe përlogaritjeve të kryera mbi bazën e sasisë së parashikuar dhe çmimit referencë për njësi, Grupi i Punës përpunoi rezultatet në tabelën përmbledhëse të mëposhtme.

Vlera e përgjithshme e Marrëveshjes Kuadër për periudhën 2026 - 31.03.2027, për objektin e prokurimit:

“Blerje Karburant për Bashkinë Durrës dhe institucionet në varësi të saj”

Rezulton si më poshtë:

VLERA E FONDIT LIMIT:

177,797,542 (Njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH,

6. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejen e Tregtimit të Karburanteve, në përputhje me Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar.

Argumentimi ligjor dhe i AK: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, të VKM Nr.970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur, furnizim i cili mund të ofrohet vetëm nga shoqëritë e tregtimit me shumicë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43 pika 2/a dhe pika 3 të VKM-se nr. 285 dt. 19.05.2021 të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës dhe viteve të kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të

Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi ligjor dhe i AK : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se:

"Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit", si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.", si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, paraqitja e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2025** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kushtet e mesiperme duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi ligjor dhe i AK: Kjo kërkesë është bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet, në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 "Për QKB" i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 "Për QKR", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi i AK: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Fletë analize për karburantin e tregtuar, të lëshuar brenda 60 ditëve të hapjes së ofertës nga ISHTI sipas standardeve në fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vertetim të leshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive përgjatë vitit 2025.

Argumentimi ligjor pikat 2.3.2 dhe 2.3.3 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c.) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Argumentimi i AK për pikat 2.3.2 dhe 2.3.3: Në funksion të përlogaritjes dhe hartimit të kontratave në zbatim, ky kriter përben element thelbësor në përcaktimin e çmimit të karburantit (psh densiteti është pasqyruar në flete analize). AK gjykon dhe argumenton se flete analiza e kerkuar brenda 6 (tre) muajve nga data e hapjes së tenderit motivohet; sepse jep vlerën e densitetit të cili shërben për kontrollin e çmimit për njësi, vlerë që influencon ndjeshëm në çmimin për njësi (referuar katalogut të OBP-së dhe publikuar nga APP-ja vlerat e densitetit midis kufirit minimal dhe kufirit maksimal luhaten nga 820–845 kg/m³ (EN 590) për gazoil, për benzinë pa plumb në intervalin 720–775 kg/m³ (EN 228) dhe referuar procedurave të viteve para për këtë objekt prokurimi nga ente të tjera publike për efekt krahasimi, AK konstaton se afati 60 ditë është mjaft tolerant, krahasuar edhe me autoritete të tjera kontraktore.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër furnizimin me karburant pranë stacioneve të shitjes me pakicë, me shërbim 24 (njëzet e katër) orë në ditë, 7 ditë në javë, përmes përdorimit të kartave elektronike të personalizuar me targën e secilit automjet të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të këtij të fundit.
- Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 3 (tre) pika shpërndarjeje brenda territorit të Bashkisë Durrës, të cilat duhet të deklarohen qartë në ofertë me adresë të plotë (Adresa 1, Adresa 2, Adresa 3). Për secilën pikë duhet të specifikohet forma e disponimit (pronësi, qira, përdorim apo marrëveshje tjetër ligjore).

Nr	Bashkia Durrës	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1			
2			
3			
4			
5			
6			

**Etj- Nënkupton të gjitha stacionet të shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).*

Të gjitha stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë e lëshuar nga pushteti vendor për tregtimin me pakicë të karburanteve;
- Leje mjedisore përkatëse e lëshuar nga QKL;
- Vërtetim teknik i lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikatë mbrojtjeje nga zjarri e lëshuar nga MZSH;
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, e vlefshme në datën e hapjes së ofertës;
- Fletë-analizë e lëshuar nga ISHTI, e cila duhet të jetë lëshuar jo më herët se 60 ditë nga data e hapjes së ofertave.
- Operatorët duhet të paraqesin Certifikata ISO 9001:2015, ose ekuivalente ISO 14001:2015 (Mjedisi) dhe ISO 45001:2018 ose ekuivalente (Siguria dhe Shëndeti në Punë), duhet t'i paraqesin këto certifikata në emër të subjektit ofertues.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata OHSAS 18001:2007 ose ekuivalente me ISO 45001:2018 (Siguria dhe Shëndeti në Punë).
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, certifikatat e sipërpërmendura duhet të paraqiten nga secili operator.

Furnizimi me karta elektronike

- Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratë si më poshtë:
 - Të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant të stacioneve të shitjes së karburantit me pakicë me shërbim 24 orë, në të gjitha ditët e javës.
 - Të deklarojë se merr përsipër me karta individuale furnizimin me karburant të subjekteve në varesi të institucioneve, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e furnizimit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Në bazë të VKM Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standardet e disiplinimit të shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, operatori ekonomik duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (web-page), ku institucionet përfituese të mund të monitorojnë furnizimet dhe konsumin e karburantit.
- Faqja e menaxhimit duhet të ofrojë të dhëna në kohë reale mbi furnizimin, përfshirë datën, orën, sasinë dhe targën e mjetit, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të vendosë një sistem kontrolli dhe monitorimi të sasisë së karburantit të furnizuar, si dhe të mundësojë akses për verifikim nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi ligjor dhe AK-së : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në përputhje me nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 5/ç dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të cilat i japin autoritetit kontraktor të drejtën të përcaktojë kritere teknike dhe organizative që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës, me qëllim garantimin e realizimit të saj në mënyrë efektive dhe në përputhje me standardet në fuqi. Gjithashtu, kërkesat janë bazuar në VKM nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, e cila detyron njësitë publike të aplikojnë mekanizma kontrolli dhe monitorimi elektronik për administrimin e konsumit të karburantit, në funksion të transparencës, gjurmueshmërisë dhe disiplinës financiare. Kërkesa për paraqitjen e Licencës së Tregtimit (Lloji A) vendoset në përputhje me Ligjin nr. 8450/1999, i ndryshuar, i cili përcakton se tregtimi i produkteve të naftës lejohet vetëm për subjektet e pajisura me licencë përkatëse. Duke qenë se objekti i prokurimit është furnizimi me karburant, kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar ligjshmërinë e aktivitetit të operatorit ekonomik dhe sigurinë e furnizimit. Kërkesa për furnizim 24 orë, përmes kartave elektronike të personalizuar, lidhet drejtpërdrejt me natyrën e aktivitetit të Autoritetit Kontraktor dhe institucioneve përfituese, të cilat operojnë në terren gjatë gjithë kohës dhe kanë nevojë për akses të menjëhershëm dhe të pandërprerë në furnizim me karburant, pa krijuar ndërprerje në ushtrimin e funksioneve publike. Përcaktimi i minimumi tre (3) pikave të shpërndarjes është proporcional me nevojën për mbulim territorial dhe garantim të aksesit të vazhdueshëm në furnizim, duke shmangur varësinë nga një pikë e vetme shpërndarjeje dhe duke reduktuar riskun operacional. Kërkesa për dokumentacion ligjor (licencë, leje mjedisore, vërtetim teknik OMVK, certifikatë MZSH, policë sigurimi dhe dokumentacion për cilësinë e karburantit) ka për qëllim verifikimin e ushtrimit të ligjshëm të aktivitetit dhe garantimin e sigurisë teknike, mjedisore dhe të cilësisë së produktit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kërkesa për sistem elektronik menaxhimi (webpage) dhe strukturë piramidale administrimi është e domosdoshme për të mundësuar kontrollin në kohë reale të konsumit, administrimin e limiteve, gjurmimin e çdo furnizimi të kryer dhe eliminimin e abuzimeve të mundshme, në përputhje me VKM nr. 561/2016. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe nuk përbën kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi është e realizueshme nga çdo operator ekonomik që ushtron aktivitet në këtë fushë. Për pasojë, kërkesat e përcaktuara janë proporcionale, të arsyetuara dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, duke garantuar realizimin e furnizimit në mënyrë të sigurt, transparente dhe të kontrollueshme.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë Certifikime të Sistemeve të Menaxhimit

Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- Certifikatë të vlefshme ISO 9001:2015 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalente e cila duhet të përfshijë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit (furnizim/shitje me pakicë të karburanteve).
- Certifikatë të vlefshme ISO 14001 për “Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalente, e cila duhet të përfshijë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- Certifikata OHSAS 18001:2007 ose ekuivalente me ISO 45001:2018 (Siguria dhe Shëndeti në Punë) ose ekuivalente.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organ certifikimi i akredituar dhe të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator duhet të paraqesë certifikatat përkatëse në përputhje me pjesën e objektit të kontratës që ka marrë përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi ligjor dhe AK-së : Kërkesat për certifikime të sistemeve të menaxhimit janë vendosur në mbështetje të nenit 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se mallrat ose shërbimet objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara. Gjithashtu, në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata të cilësisë vetëm nëse ato janë të argumentuara, proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Duke qenë se objekti i kontratës konsiston në furnizimin me karburant për institucionet publike, kërkesa për certifikime ISO 9001:2015 dhe ISO 14001 lidhet drejtpërdrejt me garantimin e menaxhimit të kontrolluar të cilësisë së produktit dhe shërbimit; sigurimit të standardeve të qëndrueshme në procesin e furnizimit; respektimit të kërkesave mjedisore në ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve. Këto kërkesa janë proporcionale me natyrën dhe rëndësinë e kontratës, pasi furnizimi me karburant përbën shërbim kritik për funksionimin e institucioneve publike dhe kërkon garanci për menaxhim cilësor dhe mjedisor të aktivitetit. Standardi ISO 45001:2018 përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të siguri dhe shëndetit në punë, me qëllim parandalimin e aksidenteve, dëmtimeve profesionale dhe sëmundjeve të lidhura me aktivitetin e punës. **Pranohen gjithashtu certifikime ekuivalente të lëshuara nga organe të akredituara, që provojnë aplikimin e sistemeve të barasvlershme të menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit.**

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet

e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” i ndryshuar: “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, autoriteti/enti kontraktor grupi i punës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

II. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Karburanti i ofruar duhet të jetë i cilësisë së lartë dhe të përmbushë kërkesat e standardeve europiane EN 590 për gazolin 10 ppm ULSD dhe EN 228 për benzinën pa plumb 10 ppm, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për cilësinë e karburanteve.

1. Specifikimet teknike të Naftës (Gazoil 10ppm ULSD)

Lëndë djegëse për automjete naftë 10ppm ULSD

Te dhënat teknike janë marre nga faqja e internetit te Inspektoriatit Qendror Teknik per Naftë 10ppm ULSD i cili i referohet Gazoil standart **SSH EN 590:2013+A1:2017** ose ekuivalente **SSHEN590:2022**

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës
		minimale	maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165

Indeksi i cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d, e}	% (m/m)	-	11	EN 12916
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	deri 10.0 (01.01.2009)	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndohtja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
Vetitë lubrifikuese, diametric i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{h, i} distilati që vlon ÷ në 250°C, %(v/v) distilati që vlon ÷ në 350 °C, %(v/v) distilati që vlon në 95 % (v/v)	% (V/V) % (V/V) °C	85	< 65 360	EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924

Shënime

- Kërkesat e Bordit i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC, duke përfshirë amendimet 2003/17/EC, 2009/30/EC dhe 2011/63/EU.
- Shih gjithashtu pikën 5.7.1.
- Shih gjithashtu pikën 5.7.4.
- Shih gjithashtu pikën 5.7.2.
- Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklike aromatike janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.
- Shih gjithashtu pikën 5.7.3.
- Shih gjithashtu pikën 5.2.2.
- Shih gjithashtu pikën 5.2.2 të Aneksit A.
- Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për praninë e FAME, është në shqyrtim nga CEN.
- FAME i përkufizuar kërkesat sipas EN 14214, shih pikën 3.
- Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2% (V/V) FAME, qëndrueshmëria e oksidimit përcaktohet sipas EN 15751; shih kërkesat përkatëse.
- Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50% dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.

- Limitet e distilimit në 250°C dhe 350°C janë përfshirë në tarifën e karburantit të naftës të dhënave të përbashkëta të BE-së.
- EN ISO 3924 jep udhëzime për konvertimin në ISO 3405 të dhëna ekuivalente; shih gjithashtu pikën 5.7.5.

2. Specifikimet teknike të Benzinë pa plumb: (Premium Unl 10 ppm)

Lëndë djegëse për automjete – Karburant Benzinë standard EN 228:2012 + A1:2017 (E)

Duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017 ose ekuivalent, sipas standarteve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit, që është Organi Kombëtar i Standarteve në Shqipëri.

Tabela e Specifikimeve Teknike

Nga data e nënshkrimit të kontratës, operatori fituesi duhet të dorëzojë karburantin për mjetet motorrike sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Furnizimi me karburant do të vijojë të kryhet me kartat elektronike të personalizuar.

Tabela e Specifikimeve Teknike

Vetia	Njësia	Min	Max	Metoda e Testimit
Numër Oktani Kërkimi (RON)	-	95.0	-	EN ISO 5164
Numër Oktani Makine (MON)	-	85.0	-	EN ISO 5163
Përmbajtje plumbi	mg/l	-	5.0	EN 237
Densiteti (në 15°C)	kg/m ³	720.0	775.0	EN ISO 3675 / EN ISO 12185
Përmbajtje sulfuri	mg/kg	-	10.0	EN ISO 13032 / EN ISO 20846 / EN ISO 20884
Përmbajtje mangani (nga 31.12.2013)	mg/l	-	2.0	EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit	min	360	-	EN ISO 7536
Përmbajtje e gomës ekzistente (solvent i larë)	mg/100ml	-	5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri (3h në 50°C)	vlerësim	Klasi 1	-	EN ISO 2160
Dukshmëria	-	I qartë dhe i ndritshëm	-	Inspektim vizual

Përbërja kimike

Parametri	Njësia	Kufizimi	Metoda
Përmbajtje e tipit të hidrokarbonit	% (V/V)		
- Olefine	% (V/V)	max 18.0	EN 15553 / EN ISO 22854
- Aromatikë	% (V/V)	max 35.0	EN 15553
Përmbajtje e benzenit	% (V/V)	max 1.00	EN 238 / EN 12177 / EN ISO 22854

Përmbajtje e oksigjenit	% (m/m)	max 2.7	EN 1601 / EN 13132 / EN ISO 22854
-------------------------	---------	---------	-----------------------------------

Substanca	% (V/V)	Standardi
Metanol	max 3.0	EN 1601
Etanol	max 5.0	EN 13132
Alkool iso-propil	-	EN ISO 22854
Alkool tert-butil	-	EN ISO 22854
Eter (≤ 5 atome C)	përzierje brenda kufirit 2.7% (m/m) oksigjen total	EN ISO 22854
Oksigjenate të tjera	-	EN ISO 22854

SHËNIME

- Kërkesat e theksuara me bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC dhe amendamenteve përkatëse.
- (a) Shih gjithashtu pikën 5.7.1.
- (b) Një korrigjim prej 1.2 për MON dhe RON duhet të zbatohet për përllogaritjen e rezultatit final sipas Direktivës 98/70/EC.
- (c) Shih gjithashtu pikën 5.7.2.
- (d) Shih gjithashtu pikën 5.3.
- (e) Dukshmëria duhet të përcaktohet në temperaturë ambiente.
- (f) Duhet të shtohen agjentë stabilizues.
- (g) Kur përdoret etanol si komponent përzierjeje, duhet të jetë në përputhje me EN 15376.
- (h) Përmbajtja e oksigjenit në benzinë pa plumb nuk duhet të kalojë 2.7% (m/m).
- (i) Një CEN/TR mbi përzierjet e oksigjenateve është në përgatitje.
- (j) Eterë dhe monoalkoole të tjera me pikë zierjeje më të lartë duhet të jenë sipas Tabelës 4.

Argumentimi ligjor dhe AK-së : Standartet e paraqitura janë standarte të blera nga ana e Autoritetit Kontraktor prej Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS), si Organi Kombëtar i Standardizimit në Republikën e Shqipërisë. Duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në brendësi të standarteve që shet, as Autoriteti Kontraktor në rolin e blerësit nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime. Në keto kushte sqarojmë se, për çdo standart të përmendur në brendësi të çdo standarti kryesor lejohet paraqitja e ekuivalentit të tij, qoftë ai dhe Standarti Shqiptar (SSH).

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e furnizimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet

nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës.